



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 15/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Algemi” shpk - Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: K.R.M “Pastrimi” - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613/18/9057/2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Lipjan, më datë: 04.02.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Algemi” shpk - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613/18/9057/2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Lipjan.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613/18/9057/2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Algemi” shpk - Lipjan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 30.11.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:20.12.2018, ku kanë marrë pjesë dy (2) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: “Algemi” shpk - Lipjan, si tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 21.12.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Algemi” shpk - Lipjan, me dt: 28.12.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 03.01.2019, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Algemi” shpk - Lipjan, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Algemi” shpk - Lipjan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10 Janar 2019, me nr. 15/19, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613/18/9057/2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 10, 65.3 dhe 4, nenin 67. 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.01.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 22.01.2019, sqaron:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë deklarata nën betim e pa plotësuar

eksperti shqyrtues konstaton se në bazë të dëshmive që posedon pjesa kryesore e deklaratës nën betim është e plotësuar e vulosur dhe e nënshkruar, vetëm në paragrafin e parë mungon emri i operatorit ekonomik por duke u bazuar në LPP-në nën 59 paragrafi 4. ku thotë:

*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

Nga sqarimet që u dhanë me lartë AK mund të konsideroj si devijim të vogël mungesën e emrit të OE në paragrafin një (1) në deklaratës nën betim. Dhe në bazë të kësaj që u tha më lartë del se ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë K.R.M "Pastrimi" nuk ka ofruar dëshmi vërtetimin nga gjykata kompetente me kohë, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka të bashkangjitur këtë vërtetim, dhe data e kësaj certifikate e lëshuar nga gjykata themelore Prishtinë është 21.12.2018 tri ditë para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së ku ky vërtetim është kërkuar vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës prandaj bazuar në sqarimet e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se tek OE i rekomanduar për kontratë në vendimin e AK figuron emri i Burim Kelmendit, ndërsa në hapje ka qenë prezent drejtori i OE Pastrimi, eksperti shqyrtues konstaton se ligji i Prokurimit Publik nuk e kufizon se kush mund të marr pjesë në seancën e hapjes. Ku neni 58 i LPP-së paragrafi 2 thotë:

*Të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe kohën e specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni. Tenderët që janë dorëzuar pas afatit të fundit kohor nuk do të hapen ose shqyrtohen dhe menjëherë do t'i kthehen të pahapura operatorëve ekonomik që i kanë dorëzuar ato. Çdo tenderues ka të drejtë që të dërgojë një përfaqësues që të vëzhgojë hapjen e tenderëve.*

Duke u bazuar ne nenin 58 të LPP dhe në sqarimet që u dhanë më lartë, OE nuk janë të kufizuar dhe mund të dërgon një përfaqësues qe të marr pjesë në procesin e hapjes. Nga kjo që u tha më lartë del së ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Pretendimi i radhës i OE ankues është së AK nuk i ka dhënë qasje në dokumente, eksperti shqyrtues në bazë të dëshmive që OE Algemi sh.p.k ka bashkangjitur në ankesën e tij ku gjinden disa imella, sqaron se me datën 27.12.2018 OE Algemi sh.p.k ka kërkuar qasje në dokument, dhe me datën 28.12.2018 është ftuar nga drejtori i prokurimit në Lipjan Adem Duriqi, që të këtë qasje në dokumente në orën 14:00. Eksperti shqyrtues sqaron së nuk ka dëshmi të bashkangjitur për përgjigjen qe i ka dhënë drejtori i prokurimit për mos lejim në qasje në dokument. Mirëpo disa ditë me vonë OE “Algemi” sh.p.k ka kërkuar përsëri qasje në dokument përmes e-mailit, duke iu drejtuar drejtorit të prokurimit Adem Duriqit: *pasi qe nuk me dhe mundësin të kem qasje në dokumentacionin e OE Pastrimi me datën 28.12.2018 në orën 14:00, siç me njoftove përmes e-mailit dhe me premtove së do të me ftosh një ditë tjetër, kjo nuk ndodhi, unë kërkoj prapë që të kem qasje në dokumentacion .*

Eksperti shqyrtuese konstaton se OE ankues nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme sa i përket këtij pretendimi, ku OE ankues thotë se drejtori i prokurimit Adem Duriqi i ka refuzuar qasjen në dokument me arsyetimin se nuk është prezent edhe përfaqësuesi i OE K.R.M “Pastrimi” Xhelal Krasniqi. Mirëpo duke u bazuar në RRUOPP neni 7 paragrafi 7.4 thotë:

*Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete të biznesit, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për me pak se 20 faqe A4 dhe qasje direktet të formës elektronike do të jenë të liruara nga tarifa.*

Nga të lartcekurat eksperti shqyrtues konstaton së Autoriteti Kontraktues është dashur ti jap qasje në dokumente OE Algemi sh.p.k. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se dokumentacioni i OE Algemi sh.p.k ka qenë i kompletuar por pasi qe mungonte kopja bazë, zarfi është mbetur i hapur dhe është manipuluar. Eksperti shqyrtues në bazë të dëshmive qe posedon në ofertën e OE Algemi sh.p.k mungon: Kopja e tenderit, Sigurimi i tenderit, Licenca

për ushtrim të veprimtarisë për menaxhim me prona publike. OE ankues nuk ka sjellë dëshmi se është manipuluar me ofertën e tij. Nga kjo që u tha më lartë del se ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE K.R.M Pastrimi është me çmimin me të lartë, eksperti shqyrtues sqaron se pasi që ofertës së OE Algemi sh.p.k i mungojnë dokumentet si: Kopja e tenderit, Sigurimi i tenderit, Licenca për ushtrim të veprimtarisë për menaxhim me prona publike nga komisioni i vlerësimit është eliminuar si i papërgjegjshëm, ndërsa sipas komisionit të vlerësimit OE K.R.M Pastrimi është OE i vetëm i cili ka qenë i përgjegjshëm dhe i ka plotësuar kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Nga sqarimet që u dhanë më lartë del se ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.4). Dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues – KK – Lipjan, me datë: 23.01.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: “Algemi” shpk - Lipjan, me datë: 29.01.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.01.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Mehmeti deklaroj: Kontratën e pare e kem fituar me 2014 dhe pikërisht në muajin shkurt kanë filluar inatet sepse janë lokale te cilat i posedon Komuna në hapësirat e tregut dhe unë jam obligativ që ti paguaj çdo dt: 05 te muajit vijues por ka pas telashe se ujërat e zeza te fshatit, Gracke kanë qarkulluar rregullisht në dyshemenë e lokalit Thertore me lokal përcjellës dhe lokali i Automjeteve ku në mes te lokalit është Puseta e kanalizimit, ku kam edhe dëshmi përmes fotografive te cilat po ju prezantoj (prezantoj panelit fotografit në fund te seancës i dorëzon). Arsyeja e eliminimit me dt 20 është bërë hapja e ofertave në Kërkesë te AK-së është kërkuar origjinal dhe një kopje unë nuk e kam

dorëzuar kopjen tjetër bashkë me origjinalin por vetëm Originalin, dhe AK në ora 14 është bërë hapja. Ku unë para hapjes kam shkuar te zyrtarja e AK-së për të dorëzuar kopjen por ata nuk ma kanë pranuar. Ne vazhdim po ju sqaroj edhe për shkeljet e AK-së që kanë shpall fitues OE-në e pa përgjegjshëm sepse i ka munguar deklarata nën betim e paplotësuar dhe e pa vulosur ku mua me ka njoftuar një nëpunës i komunës që ka marr pjesë në vlerësimin e këtij aktiviteti i cili ka pas dëshirë të mbetet anonim. Dhe kërkoj nga Paneli që lënda të shkojë në rivlerësim.

Në seancën për shqyrtim kryesor të dt 04.02.2019, përfaqësuesit e AK-së kanë munguar dhe nuk e kanë arsyetuar mospjesëmarrjen e tyre duke mos kërkuar shtyrjen e seancës së sotme për ndonjë datë tjetër, sqarojmë se të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt nga OSHP-ja.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti shqyrtues Znj. Beka deklaroj: Unë qëndroj prapa raportit tim të dorëzuar me dt: 22.01.2019.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Lidhur me pretendimin OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë deklaratën nën betim e ka të pa plotësuar, konstaton se duke u bazuar edhe në sqarimet e dhëna nga ana e ekspertit shqyrtues sqarojmë se pjesa kryesore e deklaratës nën betim është e plotësuar e vulosur dhe e nënshkruar, vetëm në paragrafin e parë mungon emri i operatorit ekonomik por tek pjesa: Identifikimi i Operatorit Ekonomik është e plotësuar: Emri, Adresa Nënshkrimi dhe vula e OE-së, e që duke u bazuar në LPP-në nën 59 paragrafin 4. Thuhet:

*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

ga sqarimet që u dhanë me lartë AK mund të konsideroj si devijim të vogël mungesën e emrit të OE në paragrafin një (1) në deklaratën nën betim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë K.R.M “Pastrimi” nuk ka ofruar dëshmi vërtetimin nga gjykata kompetente me kohë. Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka të bashkangjitur këtë vërtetim, dhe data e kësaj certifikate e lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë është 21.12.2018, tri ditë para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, ku ky vërtetim është kërkuar vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se tek OE i rekomanduar për kontratë në vendimin e AK-së figuron emri i Burim Kelmendit, ndërsa në hapje ka qenë prezent drejtori i OE Pastrimi. Paneli shqyrtues konstaton se ligji i Prokurimit Publik nuk e kufizon se kush mund të marr pjesë në seancën e hapjes. Ku neni 58 i LPP-së paragrafi 2 thuhet :

*Të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe kohën e specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni. Tenderët që janë dorëzuar pas afatit të fundit kohor nuk do të hapen ose shqyrtohen dhe menjëherë do t'i kthehen të pahapura operatorëve ekonomik që i kanë dorëzuar ato. Çdo tenderues ka te drejtë që të dërgojë një përfaqësues që të vëzhgojë hapjen e tenderëve.*

Andaj duke u bazuar në nenin 58 të LPP dhe në sqarimet që u dhanë si më lartë, OE-të nuk janë të kufizuara dhe mund të dërgon një përfaqësues që të marr pjesë në procesin e hapjes.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK nuk i ka dhënë qasje në dokumente, Paneli shqyrtues në bazë të dëshmive që OE “Algemi” sh.p.k ka bashkangjitur në ankesën e tij ku gjinden disa e-mela, sqaron se me datën 27.12.2018 OE Algemi sh.p.k ka kërkuar qasje në dokument, dhe me datën 28.12.2018 është ftuar nga drejtori i prokurimit në Lipjan Adem Duriqi, që të këtë qasje në dokumente në orën 14:00. Paneli shqyrtues sqaron se nuk ka dëshmi të bashkangjitur në shkresat e dorëzuara në OSHP, për përgjigjen që i ka dhënë drejtori i prokurimit për mos lejim në qasje në dokument të njëjtit operator ekonomik. Mirëpo disa ditë më vonë OE Algemi sh.p.k ka kërkuar përsëri qasje në dokument përmes e-mailit, duke iu drejtuar drejtorit të prokurimit Adem Duriqit: *pasi qe nuk me dhe mundësin të kem qasje në dokumentacionin e OE Pastrimi me datën 28.12.2018 në orën 14:00, siç me njoftove përmes e-mailit dhe me premtove së do të me ftosh një ditë tjetër, kjo nuk ndodhi, unë kërkoj prapë që të kem qasje në dokumentacion.*

Paneli shqyrtuese konstaton se OE ankues nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme sa i përket këtij pretendimi, ku OE ankues thotë se drejtori i prokurimit Adem Duriqi i ka refuzuar qasjen në dokument me arsyetimin se nuk është prezent edhe përfaqësuesi i OE K.R.M “Pastrimi” Xhelal Krasniqi. Mirëpo duke u bazuar në

RRUOPP neni 7 paragrafi 7.4 thuhet :

*Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete të biznesit, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për me pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të lira nga tarifa.*

Paneli shqyrtues konstaton së Autoriteti Kontraktues duhet ti jap qasje në dokumente çdo operatori ekonomik i cili kërkon një gjë të tillë në pajtim me dispozitat ligjore dhe nën ligjore të cekura si më lart AK-ja nuk duhet ndjekur praktika të cilat i ndalohet operatorëve ekonomik qasja në dokumentacione sepse për veprime të këtilla OSHP-ja mund të merr masa ndaj personave përgjegjës të AK-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se dokumentacioni i OE Algemi sh.p.k ka qenë i kompletuar por pasi që mungonte kopja bazë, zarfi është mbetur i hapur dhe është manipuluar. Paneli shqyrtues në bazë të dëshmive që posedon si dhe sqarimeve të dhëna nga ana e ekspertit shqyrtues konstaton se në ofertën e OE Algemi sh.p.k mungon: Kopja e tenderit, Sigurimi i tenderit, Licenca për ushtrim të veprimtarisë për menaxhim me prona publike. OE ankues nuk ka sjellë dëshmi se është manipuluar me ofertën e tij, dhe nuk ka mundur ta argumentoj me prova atë që ka deklaruar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE K.R.M Pastrimi është me çmimin më të lartë. Paneli shqyrtues sqaron se duke pas parasysh faktin se OE Algemi sh.p.k i mungojnë dokumentet si: Kopja e tenderit, Sigurimi i tenderit, Licenca për ushtrim të veprimtarisë për menaxhim me prona publike nga komisioni i vlerësimit është eliminuar si i papërgjegjshëm, ndërsa sipas komisionit të vlerësimit OE K.R.M Pastrimi është OE i vetëm i cili ka qenë i përgjegjshëm dhe i ka plotësuar kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, konstatojmë se AK-ja ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-së për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Po ashtu vlerësimi i ofertave është bërë në pajtim me nenin 6,7, 59, 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - KK - Lipjan

1x1 OE - "Algemi" shpk - Lipjan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.